REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT DHE UJIT

V E N D I M

Nr. 29 datë 23.10.2025

PËR
MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN: "STRUKTURË APART-HOTEL 5 DHE 7 KATE MBI TOKË DHE 2 KATE PARKIM NËNTOKË", ME VENDNDODHJE NË RRUGËN "E ELBASANIT", BASHKIA TIRANË

Në mbështetje të neneve 27, 28 të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar; Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar; Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit" i ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues shoqërisë "Xheluks Construksion" sh.p.k., Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit,

VENDOSI:

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për objektin: "Strukturë Apart-Hotel 5 dhe 7 kate mbi tokë dhe 2 kate parkim nëntokë", me vendndodhje në Rrugën "E Elbasanit", Bashkia Tiranë, me subjekt zhvillues shoqërinë "Xheluks" sh.p.k.

2. Harta e Planvendosjes së Strukturave i bashkëlidhet këtij vendimi si pjesë përbërëse e tij.

3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet kërkuesit vetëm pas:
   a) plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor;
   b) pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Tiranë.

4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.

5. Vendimi, pasi nënshkruhet nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA

MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

BELINDA BALLUKU

ANËTAR / SEKRETAR I KKTU-SË

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

ADELAJDA ROKA

Nënshkruar më datë 19/01/ 2026